



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLICA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga një parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 88-të, të mbajtur më 16.06.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-2762/1 të datës 08.06.2023 për ngritjen e procedurës kundër drejtuesit të falimentimit -----, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për shkak se KSHPK-ja tashmë ka vepruar në të njëjtin denoncim me të njëjtat pretendime dhe ka marrë vendim brenda juridiksionit të saj.

Lënda me numër 12-1283/1 të datës 23.03.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së- brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Më datë 23.03.2021, një parashtrues i njohur ka paraqitur denoncim të regjistruar me numër 12-1283/1, datë 23.03.2021, me titull Iniciativë për fillimin e procedimit ndaj drejtuesit të falimentimit të ----- --. Në denoncim janë ngritur pretendime ndaj personit të specifikuar si drejtues i falimentimit të NP për rregullimin dhe shfrytëzimin e tokës ndërtimore ----- në falimentim, me kërkesë për ngritjen e procedurës ndaj tij, për shkak të dyshimeve për ligjshmërinë e zhvillimit të procedurës së falimentimit, veçanërisht në pjesën e shpërndarjes së mjeteve që duhej t'u shpërndaheshin kreditorëve të falimentimit. Në denoncimin e dorëzuar, thuhet se nga ana e parashtruesve, ky rast është denoncuar në Drejtorinë e Policisë Financiare, ku kanë dorëzuar edhe dokumentacionin e plotë dhe nga ku janë njoftuar se ndaj personit të përmendur ka iniciuar procedurë pranë PTHP-së –Shkup.

Gjatë shqyrtimit të denoncimit, KSHPK-ja ka konstatuar se në rastin bëhet fjalë për denoncim identik ose të njëjtë, i cili përmban të njëjtat pretendime, për të cilat KSHPK-ja ka vepruar tashmë në lëndën nr. 12 - 5371/1 datë 26.11.2019 dhe ka vendosur. në seancën e 65-të të mbajtur më 15.04.2022, në të cilën ka marrë vendim në varësi të saj, regjistruar me numër 12-200/7, datë 19.04.2022, me të cilin është ndërprerë procedura për lëndën, për faktin se rasti. në fjalë trajtohet nga autoritete të tjera kompetente dhe procedurat janë duke u zhvilluar. Vendimi në fjalë është publikuar në faqen e KSHPK-së.

Duke marrë parasysh sa më sipër, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka kompetencë për veprime të më tutjeshme në rastin në fjalë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar: Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: J.C,
Miratoi: Mr. V.G, anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHETETËROR

PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar,
Katica Nikolovska

